



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Datë 11.04.2018, ora 9:30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi –nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi dhe miratimi i projektkalendarit të punës së Komisionit për periudhën 15 prill – 3 maj 2019.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhambulla, Vilma Bello.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Sot jemi mbledhur për të diskutuar projektkalendarin e punës së Komisionit për periudhën 15 prill – 3 maj, në përshtatje me kalendarin e punës së Kuvendit, që do të miratohet në seancën e sotme.

Për ditën e hënë, 15 prill, është planifikuar seanca dëgjimore me drejtues të RTSH-së për shqyrtimin Raportit të veprimtarisë vjetore RTSH -s për vitin 2018.

Për ditën e martë, më 16 prill, ora 10.00, është parashikuar diskutimi dhe miratimi i 2 projektrezolutave, përkatësisht:

- Diskutimi dhe miratimi i projektrezolutës për Raportin e veprimtarisë vjetore AMA-s për vitin 2018 (*parashikuar për seancën e datës 18 prill*).
- Diskutimi dhe miratimi i projektrezolutës për Raportin e veprimtarisë vjetore RTSH -s për vitin 2018 (*parashikuar për seancën e datën 8 maj*).

Pra, të dyja raportet për veprimtaritë vjetore të AMA –s dhe RTSH-së janë parashikuar të kalojnë në seancat plenare të datave: AMA- më datë 18 prill, ndërsa për RTSH-në do të përcaktohet sot.

Për datën 17 prill kemi vënë 2 pika:

1. Kalendari i dëgjësave për shqyrtimin e projektligjit “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, *komision përgjegjës*.
2. Vizitë pune në Fier.

Unë mendoj që kalendarin e dëgjësave për shqyrtimin e projektligjit “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, meqë nuk do të na kërkojë shumë angazhim, ta zhvillojmë të enjten, pra si sot java, më datë 18 prill, këtu, në ambientet e Sallës së Kuvendit dhe për të mërkurën lëmë vetëm vizitat në Fier, ku do të vizitojmë një shkollë 9-vjeçare, një shkollë të mesme dhe një *site* kulturor. Për këtë të lajmërojmë OSBE-në, për t’i lënë kohën e duhur për realizimin e vizitës. Presim Adelinën të na përgatisë një program për vizitat nëpër shkollat.

Ndërkohë, kemi komunikuar edhe me komisionin homolog të Kuvendit të Kosovës dhe ata na presin më mirë në maj sesa tani në prill.

Përveç kësaj, kemi për të bërë edhe vizitën në Korçë. Për Korçën është një ide që mund të bëhet të martën dhe të mërkurën, në datat 23 dhe 24 prill, pra me një natë fjetje atje.

Gjithashtu, kemi komunikuar edhe me Ministren e Kulturës, për një dëgjësë, që është lënë për datën 30 prill.

Jemi dakort për këto që parashtrova?

Dëgjesat për projektligjin mund t’i bëjmë edhe të hënën, menjëherë pas mbledhjes së grupit.

Ismet Beqiraj – Mendoj që të nisemi të hënë, menjëherë pas mbledhjes së grupit.

Milva Ekonomi – Por duhen bërë projektrezolutat, pasi raportet për aktivitetin vjetor të AMA-s dhe RTSH-së janë caktuar me data për seancë plenare.

Ismet Beqiraj – Nuk e kisha fjalën për këtë javë, por them që në përgjithësi për këto vizitat, mbarojmë mbledhjen e grupit dhe nisemi. Jo të mërkurën, para seancës parlamentare, pasi na duhet të përgatitemi për të.

Milva Ekonomi – Jeni për datat 22 dhe 23 për vizitën në Korçë?

Megjithatë unë jam e mendimit që më mirë datën 22 ta përdornim për dëgjesat.

Ismet Beqiraj – Por kemi edhe fushatën elektorale, edhe ngarkesat e tjera...

Milva Ekonomi – Por fushata elektorale është përveç mbledhjeve të komisionit! Por mos harroni që janë edhe ditët e pushimit nga Pashkët: më 21 prill është Pashka Katolike, më 28 është ajo Ortodokse. Pra, të hënat janë ditë pushimi!

Ismet Beqiraj – Po s’ka gjë, mund të shkojmë edhe në këto ditë!

Milva Ekonomi - Por kur do të shkojmë, se nuk do të kemi më kohë, pasi në maj do të fillojë tamam fushata?!

Ismeti Beqiraj – Të mërkurën nuk e bëjmë dot.

Milva Ekonomi – Po e përsëris që në maj fillojnë tamam aktivitetet elektorale dhe nuk do të kemi shumë kohë për mbledhje komisioni. Tani duhet të dorëzojmë materiale në Kuvend.

Ismet Beqiraj – Pra, jam i mendimit që mos ta shpërdorojmë kohën e ditës së hënë.

Milva Ekonomi – Ismet, ditët e hëna kemi pushim, nuk mund..

Bujar Çela – Hidhni në votë mendimin e Ismetit...

Milva Ekonomi – Dakort, e votojmë. Kush është dakort me datat 23 dhe 24 për vizitën në Korçë?

Lindita Nikolla – Por nuk ka alternativë tjetër, pasi e hëna është pushim!

Fidel Ylli – Të shfrytëzojmë ditët e javës nga e hëna deri të enjten. Të preme, të shtunë kemi zonë, kemi njerëz, kemi punë për të bërë. Lëreni të premtën, mos e përfshini. Kemi fushatën dhe duhet të shkojmë në zonë.

Milva Ekonomi - Atëherë ramë dakord për këtë kalendar dhe të enjten që vjen, vendosim për dëgjesat për projektligjin.

Ju lutem, stafi të lajmërojë OSBE-në për datat e vizitave.

Fidel Ylli – Po nisja, si do të jetë?

Milva Ekonomi – Do të na lajmërojnë ata, duke konfirmuar datat, dhe na vjen axhenda, siç bëmë për vizitën në Butrint dhe Gjirokastrë. Prandaj po them që stafi të lidhet me OSBE-në.

Për Fierin, do të na ndihmohet edhe ti, Adelina, për të përcaktuar shkollat që do të vizitojmë.

Ismet Beqiraj – Pse mos e bëjmë të hënë?

Milva Ekonomi - Ismet, duhet të dorëzojmë projektrezolutat për raportet 1-vjeçare në Kuvend. Duhet të jenë dorëzuar 48 orë përpara miratimit të rezolutave.

Fidel Ylli – Po për Kosovën, si do ta lëmë?

Milva Ekonomi - Ata kanë propozuar 13 – 14 majin, apo jo Muhamet? Nuk e kanë sjellë akoma me shkrim, por nga bisedimet që janë bërë.

Fidel Ylli - Në lidhje me Korçën, mendoj që të nesërmen, pra më datë 24 prill, të shkojmë në Voskopojë, për të vizituar disa prej kishave, dhe që andaj, kthehemi në Tiranë.

Milva Ekonomi – Dakort me propozimin e Fidelit? Pra, dakort me këtë kalendar.

I lutem sekretarisë të komunikojë me OSBE-në.

E mbylлим mbledhjen këtu.

MBYLLET MBLEDHJA

